



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 544 / Prot. 3

Durrës, më 27.04 2021

**VENDIM**  
Nr. 20, datë 27.04 2021

**PËR**  
**"PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË ME**  
**KOHË TË PLOTË, QË PËRJASHTOHEN NË MASËN 50% NGA TARIFA E**  
**SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021"**

Në mbështetje të nenit 4 "e drejta e studimit", nenit 49 "Funksionet e bordit të Administrimit", nenit 98 "të drejtat dhe detyrimet e studentëve" të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Përfshirjen në masën 50%, nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët të cilët vijojnë studimet në ciklit e parë me kohë të plotë viti akademik 2020-2021 pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të cilët vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë, 48 studentë, efekti financiar 1152000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Administratori
- Drejtorja e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**

**Ilirjana NANO**



**Cikili I dyte I studimeve me kohe te plote**  
 Perjashtuar ne masen 50% nga tarifa e shkolllimit per vitin akademik 2020-2021

FAKULTETI	Nr. Shkreses	Kriteret										Totali			
		Kriteri Nr.1 Studente, Persona me aftesi te kufizuar te vertetuar nga KMCAP	Kriteri Nr.2 Studente, Familjet e te cileve trajtohen me Ndihme Ekonomike	Kriteri Nr.4 Studentet qe I kan te dy prinderit me kufizuar te vertetuara nga KMCAP	Kriteri Nr.5 Studentet qe I kan te dy prinderit njeri prind pensionist dhe (jetri nuk jeton)	Kriteri Nr.7 Studentet rome dhe ballkano - egjipiane, te konfirmuar si te tile nga ministra perjegjese per mireqenien sociale	Kriteri nr.8 Studente, femije te ish te denuarve dhe te perndjekurve politike nga sistemi komunist ose femije me prinder te denuar politik	Studentet femije te punonjeseve te Policise se Shtetit te rene ne krye te deytres	Studente me mesatare mbi 9 (nente)						
Fakulteti I Biznesit	Shkrese nr.315 date 31.03.2021	1											1	36000	
Fakulteti I Biznesit	Shkrese me 352 date 15.04.2021	4	6										10	360000	
Fakulteti I Biznesit	Shkresa nr.381 date 26.04.2021		2										2	72000	
Fakulteti I Shkencave Politike Juridike	Shkrese nr.146/1 date 14.06.2021	4											4	144000	
Fakulteti I Shkencave Politike Juridike	Shkresa nr.135/1 date 31.03.2021	5	3										8	288000	
Fakulteti Edukimit	Shkrese nr.592 date 01.04.2021	2											2	72000	
Fakulteti Edukimit	Shkrese nr.622 date 02.04.2021												5	180000	
Fakulteti Edukimit	Shkresa nr.1004 date 21.04.2021	3	6										9	324000	
Fakulteti Edukimit	Shkresa nr.1010 date 21.04.2021												3	108000	
Fakulteti Edukimit	Shkresa nr.1216 date 26.04.2021												2	72000	
Fakulteti I Studimeve Profesionale	Shkresa nr.182/1 date 19.04.2021	1	1										2	72000	
<b>TOTALI</b>		<b>20</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>10</b>	<b>48</b>	<b>1152000</b>	



*[Handwritten signature]*